



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

VENDIM

Nr. 118 datë 16.12. 2019

**“PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, PËR
FAMILJET E EVAKUARA NGA BANESAT E TYRE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I
DATËS 26 NËNTOR 2019 ”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 30 dhe nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, pikës 5, të vendimit nr. 112, datë 11.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për një ndryshim të Vendimit Nr. 111, datë 06/12/2019 “Per miratimin e pagesës së plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019”, vendimit nr. 7, datë 08.01.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit për vitin 2019 dhe të programit Buxhetor afatmesëm 2019-2021”, të ndryshuar, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

V E N D O S I :

- 1- Miratimin e pagesës së plotë të qirasë, për një periudhë 1-vjeçare, sipas vlerës së tregut të lirë, për familjet, banesat e të cilave janë dëmtuar si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2- Afati i pagesës së qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, fillon nga muaji dhjetor 2019.
- 3- Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social të ndjekë të gjithë procesin dhe monitorojë pagesën e qirasë për familjet përfituese, si dhe të njoftojë strukturat përgjegjëse për ndërprerjen e kësaj pagese, në rast se këto familje sistemohen përfundimisht në një banesë, përpara afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
- 4- Familjet përfituese sipas këtij vendimi, përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës në masën e parashikuar nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

- 5- Efektet financiare sipas këtij vendimi do të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile parashikuar në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2019.
- 6- Ngarkohen Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
- 7- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

